

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Pkl.-Kzz.136/12
19 shkurt 2013

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit, gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës Nesrin Lushta dhe Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit, në prani të Zyrtarit ligjor të EULEX-it Holger Engelmann si procesmbajtës, në lëndën penale Pkl.-Kzz.136/12 të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër të pandehurve:

A. H. me nofkën **H.**, emri i babait Islam, mbiemri i vajzërisë së nënës **H.**, vendi i lindjes dhe vendbanimi i fundit në fshatin **H.**, data e lindjes **H.**, Kosovar, student, i pamartuar, nuk ka fëmijë, ka mbaruar shkollën e mesme, me gjendje financiare mesatare, në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 12 prillit 2007.

I shpallur fajtor nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për **dy pika të Vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerje** sipas nenit 147 paragrafit 1 pikës 4 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) dhe **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, i dënuar nga gjykata e shkallës së parë me dënim unik prej 16 viteve burgim.

Pas ankesës fajësia është vërtetuar me anë të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës kurse dënimi është ndryshuar duke rezultuar në dënimin për pikën e parë të Vrasjes së rëndë në tentativë më 28.2.2007, me 10 vite, për pikën e dytë të Vrasjes së rëndë në tentativë më 12.4.2007, me 11 vite dhe për pikën e tretë Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, 1 vit burgim, në dënimin unik prej 14 viteve burgim,

dhe

D. S., emri i babait **H.**, mbiemri i vajzërisë së nënës **H.**, vendi i lindjes **H.**, vendbanimi i fundit në **H.**, data e lindjes **H.**, Kosovar, punëtor, i pamartuar, nuk ka fëmijë, ka mbaruar shkollën e mesme, me gjendje të dobët financiare, në paraburgim prej 12 prillit 2007.

I shpallur fajtor nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për **një pikë të Vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerje** sipas nenit 147 paragrafit 1 pikës 4 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së dhe **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** sipas nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së, i dënuar nga gjykata e shkallës së parë me dënim unik prej 15 viteve dhe 6 muajve burgim.

Pas ankesës fajësia është vërtetuar me anë të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës kurse dënimi është ndryshuar duke rezultuar në dënimin për veprën penale Vrasjes së rëndë në tentativë më 12.4.2007, me 11 vite dhe për veprën penale

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, me 6 muaj burgim, në dënimin unik prej 11 viteve dhe 4 muajve burgim.

Duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur më 23 dhjetor 2011 nga avokati mbrojtës H. J. në emër të pandehurit D. dhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur më 24 janar 2012 nga avokati mbrojtës M. H. në emër të pandehurit A. H. kundër aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KŽ. 323/2010, të datës 24 gusht 2011, duke vërtetuar dhe ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. 429/2007, të datës 20 nëntor 2009, gjithashtu duke pasur parasysh përgjigjen nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPShK-së) të paraqitur më 4 shtator 2012,

D. S.

Lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në emër të pandehurit D. S. kundër aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KŽ. 323/2010, të datës 24 gusht 2011 mbi vërtetimin dhe ndryshimin e aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. 429/2007, të datës 20 nëntor 2009, REFUZOHET SI E PABAZUAR.
2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në emër të pandehurit A. H. kundër vendimeve të lartpërmendura është e BAZUAR. Të dy vendimet ANULOHEN në pjesën e lidhur me dënimin e A. H. dhe lënda kundër tij KTHEHET PËR RIGJYKIM NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Prokurori nga Zyra e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës (PSRK-së) ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve më 31 korrik 2007. Të pandehurit H. dhe Q. janë akuzuar për dy pika të veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë në bashkëkryerje [neni 147 paragrafi 1 pika 4 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së)] dhe për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas [neni 328 paragrafit 2 të KPK-së], dhe S. është akuzuar për Vrasje e rëndë në tentativë në bashkëkryerje [neni 147 paragrafi 1 pika 4 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së)] dhe për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas [neni 328 paragrafit 2 të KPK-së]. Kjo aktakuzë është konfirmuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 17 shtator 2007.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 22 prill 2008, mirëpo është shtyrë për 15 maj 2008 dhe rrjedhimisht më 29 maj, 24 qershor, 11 shtator, 8 tetor dhe 18 nëntor 2008.

Më 2 qershor 2009, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka lëshuar vendimin duke ia caktuar lëndën gjyqtarëve të EULEX-it.

Shqyrtimi gjyqësor ka rifilluar dhe është mbajtur gjatë muajve tetor dhe nëntor 2009. Më 20 nëntor 2009 është shpallur aktgjykimi ku Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka shpallur fajtorë dhe ka dënuar A. H. me dënim unik prej 16 viteve burgim, të pandehurin M. Q. me dënim unik prej 20 viteve burgim dhe të pandehurin D. S. me dënim unik prej 15 viteve dhe 6 muajve burgim.

Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit A. H. personalisht në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë më 16 gusht 2010. Avokati mbrojtës H. ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut më 31 gusht 2010, dhe avokati mbrojtës V. më 16 gusht 2010.

Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit D. S. personalisht në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë më 13 gusht 2010. Avokati mbrojtës H. J. ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut më 17 gusht 2010, dhe vetë i pandehuri personalisht më 24 gusht 2010.

Më 25 shkurt 2011, mendimi i Prokurorit të Shtetit është pranuar nga Gjykata Supreme. Prokurori Special nuk ka paraqitur përgjigje në ankesa.

Më 24 gusht 2011, Gjykata Supreme e Kosovës pas mbajtjes së seancës dhe pas këshillimit pjesërisht ka pranuar ankesat e dy të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, siç është theksuar më parë.

Më 08 dhjetor 2011, mbrojtja e D. S. ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ka kundërshtuar të dy aktgjykimet me pretendim në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të të drejtave substanciale. Është propozuar që aktgjykimi të anulohet dhe lënda të kthehet në gjykatë për rigjykim apo të ndryshohet duke e liruar të pandehurit nga të gjitha akuzat.

Më 23 janar 2012, mbrojtja e A. H. ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ka kundërshtuar të dy aktgjykimet me pretendim në shkelje të ligjit penal dhe – në lidhje me aktgjykimin e shkallës së dytë – shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).

Më 03 shtator 2012, Zyra e Prokurorit të Shtetit (ZPShK-ja) ka lëshuar përgjigjen duke propozuar që të refuzohen të dy kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuara.

I. Gjetjet e Gjykatës Supreme

1. Pranueshmëria e Kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pranueshme. Ato janë paraqitur pranë gjykatës kompetente sipas nenit 453 të KPPK-së dhe brenda afatit të përcaktuar sipas nenit 452 paragrafit 3 të KPPK-së.

2. Procedurat e zbatuara nga Gjykata Supreme

Kolegji i Gjykatës Supreme ka vendosur në seancë siç është përcaktuar me nenin 454 paragrafin 1 të KPPK-së. Palët nuk janë njoftuar në lidhje me seancën, pasi që sipas neneve 451 deri në 460 të KPPK-së, Gjykata Supreme nuk është e obliguar që t'i njoftoj palët.

3. Lidhur me meritat e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në emër të pandehurit D [REDACTED] S [REDACTED] është e pabazuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në emër të pandehurit A [REDACTED] H [REDACTED] është e bazuar.

a. Shkeljet esenciale të pretenduara të procedurës penale kundër të pandehurit D [REDACTED] S [REDACTED] sipas nenit 403 paragrafit 1 pikave 8 dhe 12 të KPPK-së:

Mbrojtja pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë i Gjykatës së Qarkut dhe aktgjykimi i shkallës së dytë i Gjykatës Supreme se gjoja kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që provat relevant nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar në lidhje me çështjet penale për të cilat i pandehuri D [REDACTED] S [REDACTED] është akuzuar. Në veçanti, i pandehuri ka deklaruar në polici më 12 prill 2007 kur avokati mbrojtës nuk ka qenë i pranishëm dhe mbrojtja i kishte nënshkruar këto deklarata "vetëm formalisht" një ditë më vonë. Deklarata në fjalë është marrë me forcë nga D [REDACTED] S [REDACTED] kundër të cilit është përdorur torturë, presion fizik dhe psikologjik.

Gjykata Supreme gjen se argumentet e mbrojtjes janë të pabazuara dhe pa merita. NË veçanti, aktgjykimi i kundërshtuar i kolegjit të shkallës së dytë është marrë me çështjen e deklaratave, gjoja të dhëna në mungesë të avokatit mbrojtës. Aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së dytë në veçanti thotë se "*P: A mund të na tregoni në prani të avokatit, atë që na thatë dje lidhur me sulmet ndaj A [REDACTED] ?*" [dhe se] deklarata e Qelës e përsërit pyetjen gati fjalë për fjalë [Gjykata Supreme e Kosovës, Aktgjykimi i datës 24 gusht 2011 (Ap.-Kz.322/2010), f.10 në versionin e gjuhës angleze].

Natyrisht, nuk përmendet në mënyrë eksplicite deklarata e D. S. lidhur me këtë. Megjithatë, konsiderohet se asnjëherë nuk ka ndodhur që në kontekstin e njëjtë vetëm nga D. S. të mos kërkohet t'i konfirmojë deklaratat e tij në prani të mbrojtjes së tij.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtjes se D. S. kishte dhënë deklaratat me dhunë dhe si pasojë e torturimit, presionit fizik dhe psikologjik, Gjykata Supreme gjen se përveç faktit se Gjykata e Qarkut tanimë kishte gjetur se “nuk ekziston asnjë shenjë e rrahjes në shkallë të gjerë”, këto akuzime nuk mbështeten fare në kontekstin e dhënë.

b. Shkeljet e pretenduara të ‘të drejtave substanciale’ të të pandehurit D. S.

Mbrojtja e D. S. përveç kësaj ka potencuar se kinse të dy aktgjykimet e kundërshtuar bëjnë shkelej të ‘të drejtave substanciale’ të të pandehurit. Nga konteksti i kërkesës me shkrim për mbrojtje të ligjshmërisë kuptohet se mbrojtja do t'i kundërshtojë shkeljet e ligjit penal nga neni 402 paragrafi 1 pika 2 e KPPK-së, që do të rezultojnë nga shkeljet e pretenduara esenciale të procedurës penale. Më tutje, kuptohet se caktimi i dënimit kundërshtohet si i pasaktë. Në fund mbrojtja me sa duket mendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur ta vërtetojë dashjen e të pandehurit dhe se D. S. ishte zënë vetëm rastësisht.

Gjykata Supreme – pa marrë parasysh se shkelja e procedurës penale nuk do të thotë domosdo se ka pasur edhe shkelej të ligjit material – në fillim gjen se nuk është vërtetuar asnjë shkelje e procedurës penale, dhe për këtë arsye argumenti i mbrojtjes bie poshtë.

Sa i përket dënimit të shqiptuar ndaj D. S. gjykata e referohet aktgjykimin të kundërshtuar të Gjykatës Supreme, ku janë rivlerësuar me kujdes të gjitha aspektet relevante në favor dhe në dëm të gjithë të pandehurve dhe lidhur me aktgjykimin e shkallës së parë është shqiptuar një dënim i ri më i butë.

Sa i përket dashjes së të pandehurit D. S. Gjykata Supreme gjen se është e vërtetë se gjykata e shkallës së parë nuk ishte në gjendje ta bazojë aktgjykimin e vet mbi pranimin e të pandehurit. Në vend të kësaj dhe për shkak të faktit se i pandehuri ishte shpallur fajtor duke u bazuar kryesisht në deklaratat e të pandehurit A. H. dhe në deklaratat e shumë dëshmitarëve, i pandehuri D. S. në veçanti ka pohuar se ‘ ai thjesht i kishte bërë shoqëri Q. dhe H. rrugës për Pejë, pa pyetur shumë’ [Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Aktgjykimi i datës 20 nëntor 2009 (P. Nr. 429/07), f.11 në versionin e gjuhës angleze]. Duke u bazuar në këtë, si dhe në shumë prova të tjera vërtetuese, gjykata e shkallës së parë arriti në përfundim se D. S. ka vepruar në marrëveshje me pjesëmarrësit e tjerë në krim. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme gjen se vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është aspak i gabueshëm, pasi që përfundimet e arritura janë të bazuara mirë në përvojat jetësore.

c. Shkeljet e pretenduara të ligjit penal në dëm të të pandehurit A [REDACTED] H [REDACTED]

Mbrojtja e të pandehurit A [REDACTED] H [REDACTED] në veçanti pretendon se të dy aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në shkallë të parë dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës në shkallë të dytë kanë bërë shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurit, se të dyja gjykatat nuk kanë vërtetuar gjendjen psikologjike të të pandehurit, edhe pse Gjykata e Qarkut në veçanti kishte urdhëruar ekspertin mjeko-ligjor Dr. M [REDACTED] G [REDACTED] ta bëjë ekzaminimin e të pandehurit me qëllim të vërtetimit të gjendjes së tij shëndetësore.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimet e mbrojtjes lidhur me çështjet e lartpërmendura janë të bazuara mirë. Në përputhje të nenit 415 paragrafit 1 pikës 1 lidhur me nenin 404 pikën 2 të KPPK-së, Gjykata 'do të ekzaminojë *ex officio* nëse është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit (neni 404 i këtij Kodi)', i cili në përputhje me nenin 404 pikën 2 të KPPK-së është veçmas një rast kur 'ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale' nga neni 11 dhe 12 i KPK-së.

Në lëndën konkrete, mbrojtja kishte dorëzuar në shkresat e lëndës një fotokopje të raportit mjekësor, të datës 04 shkurt 2008 të lëshuar nga një klinikë private, e të bazuar në ekzaminimet mjekësore të të pandehurit në vitin 2003 dhe 2005, sipas të cilit i pandehuri në atë kohë vuante nga 'Çrregullimi post traumatik i stresit'.

Edhe pse konsiderohet se në shkresat e lëndës ishte dorëzuar vetëm kopja e kësaj ekspertize dhe se ekspertiza me sa duket nuk ishte bazuar në ekzaminimet më të fundit mjekësore të të pandehurit, ekzistojnë mjaft indikacione tanimë që gjykata e shkallës së parë të analizojë *ex officio*, nëse i pandehuri kishte apo nuk kishte, dhe në çfarë mase, përgjegjësi penale në kohën e kryerjes së krimeve.

Gjykata Supreme është mjaft e vetëdijshme se autenticiteti i dokumenteve të referuara nuk pranohet – për faktin se në shkresat e lëndës ekziston vetëm kopja – dhe se 'çrregullimi mendor' i referuar i të pandehurit nuk qon detyrimisht deri te përfundimi lidhur me ndonjë sëmundje mendore relevante për krimin. Megjithatë, është qartë përtej ekspertizës së gjyqtarit që t'i vlerësojë këto çështje pa një ekspertizë të duhur mjekësore.

Pasi që as gjykata e shkallës së parë e as ajo e shkallës së dytë nuk kanë i kanë marrë parasysh këto aspekte, dy gjykatat kanë bërë shkelje të ligjit penal.

d. Shkeljet e pretenduara të procedurës penale në dëm të të pandehurit A [REDACTED] H [REDACTED] në përputhje me nenin 403 paragrafin 1 pikën 12 të KPPK-së:

Mbrojtja e të pandehurit A [REDACTED] H [REDACTED] përveç kësaj ka theksuar se aktgjykimi i shkallës së parë shkel nenin 403 paragrafin 1 pikën 12 të KPPK-së, duke thënë se '[avokati mbrojtës në ankesën e tij i propozon Gjykatës Supreme ta anulojë aktgjykimin e saj dhe ta kthejë

lëndën në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë', kurse mbrojtja ka propozuar që ' të anulohet aktgjykimi dhe lëndës të kthehet në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim'.

Gjykata Supreme nuk merr qëndrim mbi këtë çështje për faktin se argumenti si i tillë nuk është i kuptueshëm, dhe duke marrë parasysh këtë kundërshtimet nga pika c. e aktgjykimit janë të suksesshme dhe janë justifikim për anulimin e pjesës përkatëse të aktgjykimeve.

II. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Për arsytet e lartpërmendura, Gjykata Supreme përfundon siç përmendet më lart.

Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si në dispozitiv, duke u bazuar në nenin 456 të KPPK-së.

Kryetari i kolegjit

Procesmbajtës

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl.-Kzz. 136/12

PRISHTINË

19 shkurt 2013